



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 4460 Prot.

Vau Dejës me 19/07/2024

PROJEKT VENDIM

PËR:

"Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj. Sanije Reshit Salja"

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49,pika 1,2,3, neni 54,germa j, si dhe në vendimin nr.67 datë 04.07.2024 i KQZ, komisioni i mandateve i Këshillit Bashkiak Vau Dejës propozon të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Znj. **Sanije Reshit Salja** propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë, si pasojë e vakancës së krijuar nga Znj. **Paola Gjon Pleshaj**.

KRYETARI KËSHILLIT

Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa,Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail:info@vaudejes.gov.al)

RELACION

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, si pasojë e vakances së krijuar nga ish anëtarja e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Znj.Paola Pleshaj , (neni 49 pika 4 germa b), dhe në bazë të nenit 49 pika 1,2,3 si dhe në vendimin nr.67 datë 04.07.2024 të KQZ Tiranë për plotesimin e vakances në Këshillin Bashkiak Vau Dejës, me kandidatën nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë Znj.Sanije Reshit Salja, i propozojmë Këshillit Bashkiak Vau Dejës që në mbledhjen e radhës së muajit Korrik 2024, të miratojë mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj.Sanije Reshit Salja.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj



Nr. 4366/Pnol
Dt. 12.07.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë
më 10/07/2024
Nr. 1879

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: **KËSHILLIT TË BASHKISË VAU – DEJËS** ✓
Rruga “Qafa e Gurit”, Vau - Dejës

Partisë Socialiste të Shqipërisë

Sheshi “Austria”, Nr.91, Tiranë

Zj. Sanije Reshit Salja

Bushat, Shkodër

Të nderuar,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 4.07.2024, mori në shqyrtim projekt-vendimin “Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau- Dejës, pas verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatit, vendosi “Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau- Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, zj. Sanije Reshit Salja.


Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr.67, datë 4.07.2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

(Në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 04.07.2024

Nr: 67

Ora: 11.00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VAU- DEJËS, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË", ZJ. SANIJE RESHIT SALJA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3198 prot., datë 13.05.2024, këshilli i bashkisë Vau-Dejës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Paola Gjon Pleshaj, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmeërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau-Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 12, zj. Sanije Reshit Salja.

Me shkresën nr. 1491, prot., datë 4.6.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës zj. Sanije Reshit Salja, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmeërore për zgjedhjet

Data: 04.07.2024 Nr: 67
Ora: 11.00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau - Dejës,
me kandidatin nga lista shumëmeërore e "Partisë Socialiste të
Shqipërisë" zj. Sanije Reshit Salja."

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PS-9898_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Sanije Reshit Salja, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 1575 prot., datë 12.6.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr.1593 prot., datë 13.6.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zj. Sanije Reshit Salja.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 6994/1 prot., datë 20.6.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Sanije Reshit Salja, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 10256/1 prot., datë 21.6.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Sanije Reshit Salja, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Sanije Reshit Salja, në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 04.07.2024 Nr: 67
Ora: 11.00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau - Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" zj. Sanije Reshit Salja."


2

VENDOS:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatën nga lista shumemënore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Sanije Reshit Salja.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 04.07.2024 Nr: 67
Ora: 11.00

"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau - Dejës,
me kandidatën nga lista shumemënore e "Partisë Socialiste të
Shqipërisë" zj. Sanije Reshit Salja."

3